



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Maj, 2019

Takim me kryetarët e Kuvendeve të SAF e SAM e të Universiteteve Bashkëbisedë për situatën aktuale në arsim dhe për angazhimet



Në sallën e takimeve të Qendrës së studentëve është mbajtur takimi konsultativ me kryetarët e Kuvendeve të SAF e SAM e të Universiteteve. Çështje të bashkëbisedës ishin koordinimi mes niveleve sindikale dhe qendrës lidhur me trajnimet, marrëveshja për formimin e tri grupeve të pushuesve në bregdetin shqiptar dhe analiza e përfundimit të këtij viti mësimor dhe detyrat konkrete lidhur me përgatitjet për vitin e ri shkollor...(faqe 6-7)

Përgatitjet për organizimin e pushimit të anëtarëve të SBASHK



Punë e përkushtuar e komisioneve...(faqe 6)



Intervistë me kryetarin e SAF e Sam në Kamenicë, Nazim Jakupi


Nazimi është kryetar i Kuvendit të SAF e...(faqe 3)

SBASHK gjithmonë pranë anëtarësisë



Në Deçan po ashtu është mbajtur një takim solemn me anëtarët e SBASHK-ut që kanë kryer dy nga trajnimet, „Forcimin Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social” dhe “Udhëheqja dhe planifikimi strategjik...(faqe 5)

I është hapur rrugë implementimit të Ligjit për vitet e 90-



Komisioni përgatiti Udhëzimet e nevojshme administrative

Pas përpjekjeve të shumta të SBASHK-ut dhe falë përkrahjes së Kryeministrit Haradinaj, te Komisionit Parlamentar për Arsim dhe votimit të...(faqe 4)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Ky nuk ishte vit i lehtë shkollor



Shikuar nga këndi sindikal nuk ishte i lehtë ky vit shkollor. SBASHK-u, krahas aktiviteteve të shumta e të përditshme, ka zhvilluar beteja të mëdha për dy çështje madhore. Në njërën anë po bëhej e pamundura që, më në fund, punëtorët e arsimit shqip të Republikës së Kosovës të kenë ligjin e tyre meritore në anën tjetër betejë e madhe u zhvillua edhe për të përmirësuar koeficientet në Projektligjin e pagave, projektligj ky i kritikuar fuqishëm dhe arsyeshëm nga SBASHK-u. Në këto përpjekje u desh të organizohet edhe protesta e 7 shtatorit, por edhe greva njëorëshe e 28 dhjetorit, që ishin alarme të fundit para një greve të madhe që po përgatitej.

Projektligji për punëtorët e arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta gjeti mbështetje te Kryeministri

Haradinaj e pastaj edhe te anëtarët e Komisionit parlamentar për Arsim dhe te 71 delegatët e Parlamentit të Kosovës dhe ishte ky një lajm i mirë për njerëzit e dijes së një kohe të vështirë e plot sakrifica.

Fundi i këtij angazhimi mobilizoi tërë SBASHK-un për betejën tjetër. Koeficientet në Projektligjin për pagat duhej ndryshuar sepse ato që ishin po e lenin arsimin në një pozitë nënçmuese degraduese. Dialogu nuk jepte rezultate dhe prandaj nisi greva e paralajmëruar me kohë. Për 15 ditë me radhe anëtarët e SBASHK-ut, që nga çerdhet e deri edhe në Universitete dëshmuan unitet e vendosmëri të paparë.

Koeficientet pas shumë takimeve, teksa greva vazhdonte, u përmirësuan dhe në ligjin e aprovuar nga deputetët arsimit qëndron dukshëm më mirë. Më shumë se kjo SBASHK-u u kalit edhe më shumë nga këto beteja dhe tani është edhe më unik dhe dinjitetshëm vazhdon me angazhimet dhe arritjet e reja.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me kryetarin e SAF e Sam në Kamenicë, Nazim Jakupi

Nazimi - Krenohem me SBASHK-un



Nazimi është kryetar i Kuvendit të SAF e SAM në Kamenicë. Gëzon respekt të lartë mes kolegëve dhe kryetarëve të Kuvendeve të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar nga e tërë Kosova. “Jam krenar me punën që bëjë për të mirën e mësimdhënësve, fëmijëve

dhe shkollës shqipe në përgjithësi. Jam krenar që jam pjesë e SBASHK-ut “, shprehet Nazimi në këtë intervistë për gazetën tonë.

Arsimimi sot:

Kush është Nazim Jakupi?

Nazim Jakupi, i lindur më, 09.10.1958 në Kamenicë. Mësimdhënës i gjuhës dhe letërsisë shqipe në gjimnazin ‘ Ismail Qemali ’ në Kamenicë. Tërë jetën kam punuar në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve.

Arsimimi sot:

Sa është i vështirë profesioni i mësimdhënësit sot ?

Nazimi:

Sa është i vështirë, është edhe kënaqësi të punosh në profesionin e mësimdhënësit. Ndonjëherë hasim në vështirësi, por që këto tejkalohen me punë dhe dëshirën për punë.

Arsimimi sot:

Çka do të veçonit nga aktivitetet dhe arritjet e SBASHK-ut ?

Nazimi:

Do të veçoja që është një organizatë shumë e fuqishme, me një numër të madh anëtarësh. SBASHK-u qëndron karshi kërkesave të mësimdhënësve, punon për ta. Kjo u pa në grevën e fundit dhe me theks të veçantë trajnimet që janë duke u mbajtur nga SBASHK-u për mësimdhënësit e interesuar për licencim, e ri licencimet tjera.

Arsimimi sot:

Çka i sugjeroni SBASHK-ut që të fokusohet më shumë në angazhimet e veta ?

Nazimi:

Sugjerimi im për SBASHK-un është që të vazhdojë ta mbrojë dinjitetin e mësimdhënësve, të krijojë kushte më të mira për punë si dhe në veçanti të jap angazhimin maksimal për ta arritur sigurimin shëndetësor.

Arsimimi sot:

Si ndiheni si kryetari i sindikatës komunale në komunën e Kamenicës?

Nazimi:

Unë si kryetar i sindikatës komunale në komunën e Kamenicës jam përpjekur vazhdimisht t’u përgjigjem anëtarëve në nevojë. Jam i kënaqur me bashkëpunimin që i kam me sindikalistët e komunës, si dhe me SBASHK-un në tërësi.

Arsimimi sot:

Çka te shtyri te anëtarësoheni në SBASHK?

Nazimi:

Anëtarësimi në SBASHK është shumë i hershëm. Do të veçoja fillimin e viteve të 90-ta, mbajtja gjallë e edukimit dhe arsimimit në gjuhën amtare. Ishte nevojë kombëtare.

Arsimimi sot:

Çka do të veçonit nga puna e juaj ?

Nazimi:

Jam krenar me punën që bëjë për të mirën e mësimdhënësve, fëmijëve dhe shkollës shqipe në përgjithësi. Jam krenar që jam pjesë e SBASHK-ut.

Arsimimi sot:

A keni diçka për të shtuar ?

Nazimi:


Po. SBASHK-u të vazhdojë me punën e mirë që po bënë e para se gjithash ta ruaj përkushtimin dhe unitetin që ka ndër sindikalistë.

Gjatë muajit

I është hapur rrugë implementimit të Ligjit për vitet e 90-ta

Komisioni përgatiti Udhëzimet e nevojshme administrative


Pas përpjekjeve të shumta të SBASHK-ut dhe falë përkrahjes së Kryeministrit Haradinaj, te Komisionit Parlamentar për Arsim dhe votimit të pjesës më të madhe të deputetëve në Parlamentin e Kosovës punëtorët e arsimit iu gëzuan Ligjit për statutin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta. Ky Ligj u votua në mars në Parlamentin e Kosovës dhe sipas rregulloreve gjegjëse i mbeti MASHT-it që në afatin prej 6 muajsh të nxjerr udhëzimin Administrativ që ka të bëjë me implementimin e këtij Ligji.



SBASHK kishte kërkuar që kjo gjë të bëhet pa vonuar dhe pas kësaj MASHT kishte ngritur një komision për përgatitjen e Udhëzimit Administrativ.

Në këtë komision SBASHK-un e ka përfaqësuar menaxheri për financa dhe administratë,

Ymer Ymeri. Komisioni ka punuar për disa ditë me radhë dhe Udhëzimi Administrativ tani është i gatshëm dhe pret nënshkrimin e ministrit Bytyqi. Me nënshkrimin e këtij Udhëzimi Administrativ i hapet rrugë implementimit të Ligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës dhe kjo do të jetë shprehje e respektit për angazhimet dhe sakrificën e këtyre njerëzve të djes të cilët gjatë gjithë viteve të okupimit mbrojtën dritën dhe dijen duke mos u dorëzuar kurrë para dhunës që po ushtronte pushtuesi serb në vitet e 90-ta.



SBASHK gjithmonë pranë anëtarësisë

Në përpjekje për të plotësuar kërkesat shtuara për trajnime



Në mënyrë që të ndihmohen anëtarët e SBASHK-ut për arritjen e numrit të duhur të orëve të trajnimeve

për licencën e karrierës dhe më vonë edhe për gradimet për mësimdhënës të avancuar, mentor dhe mësimdhënës i merituar, SBASHK-u ka shtuar angazhimet në përpjekje për të plotësuar kresat e shtuara për 5 trajnimet e licencuara. Për t'u arritur kjo trajnerët, udhëheqësit sindikal të nivelit lokal e qendror dhe shumë nga anëtarët e SBASHK-ut vikendet i kanë kthyer në orë e ditë pune e angazhimesh. Kështu ishte në shumë komuna të Kosovës.

Në komunën e Pejës trajneri Blendor Shatri ka filluar trajnimin „Forcimin Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social" në SH.M.L.P "Shaban Spahija" në Pejë. Do kujtuar se në komunën e Pejës trajnimi për dialogun social është zhvilluar edhe në shkollën “7 Shtatori” të Arbneshtit (Vitomiricë) me pjesëmarrjen e përbashkët të kolegëve tanë shqiptarë dhe boshnjakë. Në këtë komunë me sukses është mbajtur trajnimi edhe në shkollën “XhemajlKada”. Në këto vatra arsimore trajnimin „Forcimin Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social" me sukses është duke e zhvilluar trajneri Blendor Shatri. Ky trajnim tani me sukses ka nisur

edhe në Shkollën e Mesme Teknike “Shaban Spahija”



Trajnime edhe në Lipjan e komuna të tjera



Trajnime po zhvillohen me sukses edhe në komunën e Lipjanit. Pjesëmarrësit në këtë aktivitet i ka vizituar menaxheri për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm të SBASHK-ut, YmerYmeri. Ai ka përgëzuar anëtarësinë e kësaj komune për angazhimet dhe unitetin në të gjitha

veprimtaritë sindikale e pastaj ka zhvilluar një bashkëbisedë përmbajtjesore me ta për çështjet aktuale në arsim duke u përgjigjur edhe në pyetjet e pjesëmarrësve. Aktive në organizimin e trajnimeve është edhe komuna e Vitisë. Atje pas organizimit të disa trajnimeve për dialogun social ka filluar edhe trajnimi "Aplikimi i programeve Kompjuterike në mësimdhënie" me trajnerët LiridonBahtijari dhe Avni Krasniqi. Kryetari i SAF e SAM për këtë komunë, KemajlBislimi ka lavdëruar përkushtimin e kolegëve të tij dhe të trajnerëve, të cilët me prezantimet e tyre dinamike kanë arritur të zgjojnë kërkshërinë e pjesëmarrësve me të cilët temat shpalosen shpesh në formë të bashkëbisedës.

Edhe në Deçan aktivitete të shumta sindikale

U fillua me trajnimin për mësimdhënien e gjuhës shqipe

Trajnimet "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar" me trajnerin Burim Avdijaj dhe "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm" me trajnerin prof. dr. Ali Caka në Sh.M "Lidhja e Prizrenit në Deçan. Në komunën e Deçanit kryetari i SBASHK-ut, z. RahmanJasharaj ishte i shoqëruar nga kryetari i sindikatës komunale të komunës së Pejës z. IsufLajqi. Kryetari i SBASHK-ut ka përgëzuar trajnerët dhe pjesëmarrësit e trajnimit për përkushtimin dhe po

ashtu ka zhvilluar një bashkëbisedë me ta duke u përgjigjur edhe në pyetjet që lidheshin me aktualitetin në arsimin e Kosovës.



Në Deçan po ashtu është mbajtur një takim solemn me anëtarët e SBASHK-ut që kanë kryer dy nga trajnimet, „Forcimin Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social” dhe ”Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar”. Atyre kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me zyrtaren për medie dhe për trajnime, Rrezarta Bytyqi Bahtjari dhe kryetarin e SAF e SAM për Deçanin, z. Burim Avdiu u kanë ndarë certifikatat e trajnimeve. Janë 215 anëtarë të SBASHK-ut nga Deçani që u pajisen me certifikata për trajnimet e kryera me sukses.

Angazhime të tilla kemi edhe në komunën e Kamenicës ku filloi trajnimi ”Aplikimi i programeve

Kompjuterike në mësimdhënie”. Këtë trajnim e udhëheq trajneri Xhemal Kastrati.



Përgatitjet për organizimin e pushimit të anëtarëve të SBASHK

Punë e përkushtuar e komisioneve



Kryesia e SBASHK ka autorizuar menaxherin për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri që të nis me kohë angazhimet për organizimin sa më të mirë të pushimit të 400 anëtarëve të SBASHK nga të gjitha komunat e Kosovës dhe Universitetet në bregdetin shqiptar. Në vazhdim të këtij angazhimi janë caktuar komisionet gjegjëse dhe po zhvillohen konsulta të përditshme në

mënyrë që ky aktivitet të organizohet edhe këtë vit me plot sukses sikur edhe herëve tjera. Komisioni për përgatitjen dhe shoqërimin e pushuesve i udhëhequr nga z. Ymeri kanë ndarë detyrat duke caktuar për secilin komunat gjegjëse për të cilat ata do të kujdesen që të përpilohen listat zyrtare me propozimet e arritura nga shkollat e përzgjedhura nga nivelet komunale dhe njësitë akademike.

Koordinatori i këtyre komisioneve deklaroi për gazetën tonë se përgatitjet kanë filluar me kohë dhe se kanë arritur nga një numër komunash edhe listat me emrat e pushuesve, lista këto që janë duke u analizuar dhe se pritet që në marrëveshje me kryetarët e niveleve komunale dhe të Universiteteve të caktohen se kush në cilin grup të pushuesve do të jetë pasi që këtë vit të 400 pushuesit nuk do të shkojnë në të njëjtën kohë për pushime, po do të ndahen në tri grupe pushuesish sipas datave të përcaktuara për pushim në bregdetin shqiptar.

Takim me kryetarët e Kuvendeve të SAF e SAM e të Universiteteve

Bashkëbisedë për situatën aktuale në arsim dhe për angazhimet

Në sallën e takimeve të Qendrës së studentëve është mbajtur takimi konsultativ me kryetarët e Kuvendeve të SAF e SAM e të Universiteteve. Çështje të

bashkëbisedës ishin koordinimi mes niveleve sindikale dhe qendrës lidhur me trajnimet, marrëveshja për formimin e tri grupeve të pushuesve në bregdetin

shqiptar dhe analiza e përfundimit të këtij viti mësimor dhe detyrat konkrete lidhur me përgatitjet për vitin e ri shkollor.



Kryetari i SBASHK-ut ka këshilluar kryetarët e kuvendeve të SAF e SAM që të angazhohen në koordinim të plotë me qendrën lidhur me organizimin e trajnimeve në komunat e tyre ngase tani është filluar me të pesë trajnimet dhe kërkesat janë shtuar për to, por do pasur parasysh se numri i trajnerëve është i kufizuar dhe prandaj caktimi i datave dhe i llojit të trajnimit mos të bëhet pa parë se trajnerët mund të angazhohen për to.



Shumë nga kryetarët kanë përcjellë vlerësimet e anëtarësisë duke çmuar lartë këto angazhime të

SBASHK-ut, që po mundësojnë marrjen e njohurive të reja, por edhe sigurimin e një numri orësh të trajnimeve që kërkohen me rastin e licencës së karrierës, por edhe të gradimeve.



Pas kësaj është zhvilluar bashkëbisedë lidhur me aktivitetin tradicional të dërgimit për pushime në bregdetin shqiptar të një numri të konsideruar të anëtarëve të SBASHK-ut nga gjithë komunat e Kosovës dhe Universitetet.

U tha nga koordinatori i këtij aktiviteti, Ymer Ymeri se komisionet janë duke punuar me përkushtim dhe se është koha kur nga komunat duhet të arrijnë të përzgjedhurit nga institucionet arsimore të kolegëve tanë që këtë vit do të pushojnë në bregdetin shqiptar. Pasi që nuk është e mundur që të 400 pushuesit të shkojnë në të njëjtën kohë për pushime, po duhet ky aktivitet të organizohet në tri periudha kohore, në marrëveshje me kryetarët e Kuvendeve të SAF e SAM dhe të Universiteteve u caktuan komunat që do të dërgojnë pushuesit në grupin e parë, të dytë dhe ata në grupin e tretë. U tha se anëtarët e SBASHK-ut në këtë aktivitet, përveç pushimit, do të kenë edhe aktivitete sindikale duke organizuar takime e tryeza me tema të caktuara sindikale.

Vushtrria vazhdon me trajnimet

Interesim i madh për trajnimin për teknologjinë

Kryetari i SAF e SAM të komunës së Vushtrrisë, Alush Maloku me veprimtarët tjerë sindikal në këtë komunë janë treguar shumë të angazhuar në përpjekjet që të organizohen sa më shumë trajnime për

anëtarësinë e SBASHK-ut në këtë komunë. Në Vushtri këto vikende po vazhdojnë trajnimi "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie".



Ky trajnim ka të veçantat e veta dhe prandaj edhe hetohet kujdes i shtuar i trajnerëve, por edhe i komisionit vlerësues të njohurive të arritura. Një numër i madh i mësimdhënësve të Vushtrrisë, por edhe të komunave tjera shprehin interesim të madh për këtë trajnim që është i ndarë në dy pjesë e me gjithsej 103 orë, ngase njohuritë e arritura gjatë trajnimit ju ndihmojnë atyre në përdorimin e arritjeve teknologjike në procesin mësimor duke e bërë orën mësimore shumë më dinamike dhe më frytdhënëse.



Edhe në Vushtri me kolegët që marrin pjesë në trajnime janë takuar kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj bashkë me menaxherin për financa e administratë, Ymer Ymeri duke zhvilluar bashkëbiseda me ta e duke u përgjigjur edhe në pyetjet e tyre.

Duke u nisur nga fakti se kërkesat për të pesë trajnimet e licencuara të SBASHK-ut janë shtuar shumë kërkohet që kryetarët e SAF e SAM të komunave të Kosovës të veprojnë në koordinim me përgjegjësen për trajnime dhe stafin tjetër në qendër në mënyrë që të ketë delegim të trajnerëve në këto aktivitete.

Llogaria e Pagës

Veç 

- ✓ Mirëmbajtja e llogarisë
- ✓ Mobile Banking & E-Banking
- ✓ Njoftim nga BKT Mobile
- ✓ Lëshimi i parë i Kartës së Kreditit
- ✓ Lëshimi i parë i Kartës së Debitit
- ✓ Tërheqje në ATM të BKT-së Kosovë & Shqipëri
- ✓ Blerje në POS dhe Online

Pa komision shtesë!


800 800 800 | www.bkt.ba.com

Ne jemi gjithmonë këtu!

SBASHK në bashkëpunim me BKT ka arritur marrëveshje për të ju ofruar kredi me 0% shpenzime administrative, si dhe llogari page me 50 cent/muaj.